

GJYKATA SUPREME E KOSOVES, në kolegjin e përbërë prej gjyqtareve Renate Winter, gjyqtare nderkombetare si kryetare e kolegjit, Leonard Assira, gjyqtar ndërkombëtar, dhe Zait Xhemajli, si anetare te kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Muhamet Dabiqaj, si procesmbajtës, në lenden penale kundër të akuzuarit Momcillo Trajkovic nga Kamenica, për veprën penale të krimeve të luftës kundër popullsisë civile sipas Nenit 142 të LPJ, dhe për veprën penale të vrasjes në tentative sipas Nenit 30, paragrafi 1, në bashkëlidhje me Nenin 19 të LPJ, si dhe për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve dhe lendeve eksplozive sipas nenit 199, par. 3 në bashkëlidhje me par. 1 të LPK, duke vendosur lidhur me ankesat e ushtruara nga avokatet mbrojtës të të akuzuarit kundër akt-gjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjiilan, P. Nr. 68/2000 të datës 06.03.2001, në seancën e mbajtur më dt. 30.11.2001, leshon këtë:

AKT-VENDIM

Ankesat e avokateve mbrojtës aprovohen.

Akt-Gjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjiilan, P. Nr. 68/2000, datë 06.03.2001 prapsohet dhe lenda i rikthehet së njëjtes gjykate për rishqyrtim.

Kunder të akuzuarit Momcillo Trajkovic vazhdohet paraburgimi mbi bazën e nenit 191, paragrafi 2, pika 1 e Ligjit Procedures Penale.

ARSYETIM

Gjykata e Qarkut në Gjiilan me akt-gjykimin e vet numer P. Nr. 68/200, datë 06. 03.2000, e ka gjetur të pandehurin fajtor për veprën penale:

I – vrasje në tentative në datë 27 Qershor 1999, Nenit 30, paragrafi 1, në bashkëlidhje me Nenin 19 të LPJ.

II - për veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve dhe lendeve eksplozive në Kamenicë deri në Shtator 1999, sipas nenit 199, par. 3 në bashkëlidhje me par. 1 të LPK.

III – krime lufte me çilesim sipas nenit 142 të LPJ të kryera në:

1 Prill 1999, shkaktim plaguesh me armë zjarri e R [REDACTED] R [REDACTED].

11 Prill 1999 në Kamenicë, zjarrvenie shtëpise dhe një autobuzi të H [REDACTED] R [REDACTED]

17 Prill 1999 në Kamenicë, shkaktim plaguesh me armë zjarri ndaj XH [REDACTED] L [REDACTED]

17 Prill 1999 në fshatin Krileve, rrembim dhe maltrajtim të H [REDACTED] D [REDACTED]

18 Prill 1999, shkaktim i panikut e terrorit dhe debim i popullsisë civile në fshatrat Strezovc, Leshtar, Rahovice, Krileve, dhe vrasjes së A [REDACTED] M [REDACTED], A [REDACTED] I [REDACTED], Sh [REDACTED] I [REDACTED] dhe R [REDACTED] K [REDACTED].

18 Prill 1999, në fshatin Krileve, shkaktim i plageve me armë zjarri Z [REDACTED] D [REDACTED], A [REDACTED] D [REDACTED], dhe B [REDACTED] S [REDACTED]

19 Prill 1999, në Petrovc, debim me forcë i popullsisë civile, zjarrvenie shtëpive dhe zhdukja e M [REDACTED] Sh [REDACTED] dhe F [REDACTED] Sh [REDACTED].

4 Maj 1999 në Kamenicë shkaktimi i plageve të A [REDACTED] K [REDACTED].

11 Maj 1999 rrethimi i fshatrave të Hogoshtit, Kopernices, Shispanices, Kranidellit, Karaqevës së Poshtme, Karaqevës së Siperme, Ragocices, Hodomovcit, Topanices dhe Koretin, me listen e emrave tashme të perpiluar, vrasjen e R [REDACTED] I [REDACTED], M [REDACTED] S [REDACTED], I [REDACTED] I [REDACTED], N [REDACTED] K [REDACTED], A [REDACTED] TH [REDACTED].

17 Amj 1999 në fshatin Topanice dhe në Kamenicë, rrembim, keqtrajtim dhe torturim i R [REDACTED] M [REDACTED].



Gjykata e Qarkut ne Gjilan i ka kualifikuar keto vepra si Krime kunder njerezimit.

E njejta e ka liruar te akuzuarin per vepren penale, te kualifikuar si krime lufte ne baze te nenit 142 te LPJ sipas aktakuzes te dates 21 Shtator 2000 per:

1 Prill 1999, ne Kamenice, plagosje e R [REDACTED] me arme zjarri

3 Prill 1999, ne Kamenice, plagosje e [REDACTED] B [REDACTED] dhe A [REDACTED] B [REDACTED], me nje granade dore te hedhur ne oborr

17 Prill 1999, ne Kamenice, plagosje me arme zjarri e G [REDACTED] L [REDACTED] dhe V [REDACTED] SH [REDACTED]

1 Maj 1999, ne nje vend te quajtur Qafa e Kopernices, vrasja e E [REDACTED] J [REDACTED] dhe R [REDACTED] S [REDACTED]

11 Maj 1999 ne fshatin Hodonovc, plagosje e Sh [REDACTED] B [REDACTED] dhe H [REDACTED] SH [REDACTED] ndersa udhetonin ne automjetin e tyre

20 Maj 1999 ne fshatin Koretin, plagosje e S [REDACTED] S [REDACTED], H [REDACTED] H [REDACTED] dhe XH [REDACTED] R [REDACTED]

Gjykata e Qarkut ne Gjilan ka vendosur t'i shqiptoje te akuzuarit denimin unik te 20 (njezet) viteve burgim, ne te cilen do te llogaritet koha e kaluar ne paraburgim qe prej dates 7 Shtator 1999. I akuzuari eshte i detyruar te paguaje shpenzimet e procedures penale.

Avokatet mbrojtjes te te akuzuarit kane ushtruar ankesa kunder aktgjykimit te Gjykates se Qarkut te Gjilanit, per shkak te shkeljes esenciale te dispozitave te procedures penale, shkelje te ligjit penal, verifikim te gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike dhe vendimit mbi denimin, duke i propozuar Gjykates Supreme te ndryshoje aktgjykimin e Gjykates se Qarkut dhe te liroje te akuzuarin ose aktgjykimi i kundershuar te hidhet poshte dhe lenda t'i kthehet Gjykates se shkalles se pare per rigjykim para nje kolegji tjeter me perberje te ndryshme.

Prokurori Publik i Kosoves me ane te kerkeses se tij PPA.Nr.147/2001 te dates 13.07.2001 i ka propozuar Gjykates Supreme te refuzoje ankesat e parashtruara nga avokatet mbrojtjes dhe te mbeshtese aktgjykimin e Gjykates se Qarkut ne Gjilan, nr.68/2000 te dates 06.03.2001.

Ne seancen e kolegjit moren pjese i akuzuari Momcilo Trajkoviq, avokatet e tij mbrojtjes Zhivojin Jokanoviq dhe Dragana Markoviq te cilet mbeten prane ankesave te tyre.

Prokurori Nderkombetar Michael Hartmann, i caktuar ne Prokurorine Publike, ka dorezuar nje dokument te detajuar dhe eshte i mendimit se aktgjykimi nuk e mbeshtet denimin per krime lufte ose krime kunder njerezimit, te tentatives per vrasje dhe armembajtjes pa leje.

Prandaj, ai propozoi qe Gjykata Supreme duhet te hedhe poshte denimin e te akuzuarit per shkak se gjendja faktike eshte konstatuar ne menyre te gabuar ne lidhje me te gjitha akuzat dhe per shkak se ka pasur shkelje esenciale te parimeve te procedures penale dhe lenda te kthehet per rigjykim. Me tej ai propozoi te ri-vleresohet, paraburgimi, ne ate menyre qe te zbatohen vetem dispozitat e nenit 191, al.2, pika 1 dhe 2 te LPP.

Gjykata Supreme shqyrtoi te gjitha materialet e lendes, u konsultua mbi aktgjykimin e kundershuar ne baze te nenit 376, al.1 te LPP, i vleresoi ankesat dhe konstatoi:

Ankesat e ushtruara nga avokatet mbrojtjes te te akuzuarit jane te bazuara.

Gjykata Supreme gjeti se gjendja faktike eshte vertetuar gabimisht ne lidhje me te gjitha akuzat, meqenese nuk ka asnje prove direkte ose perfundimtare qe i akuzuari ka vepruar

JOB B331



Translated by: Albert Qerimi & Bardha Shpuza

personalisht ose ka dhene urdhera qe kane ardhur deri tek krimet e pretenduara ose qe ai duhet te mbahet pergjegjes per detyrat te pergjegjesise komanduese ne lidhje me krimet e siperpermendura, dhe as qe ka prova qe tregojne qellimin e tij te vetedijshem ne rastin e tentatives per vrasje dhe as per konstatimin e paarsyetuar te gjuajtjes nga dritarja.

Me tej, Gjykata Supreme konstatoi se ka pasur shkelje thelbesore te parimeve te procedures penale, ndermjet te cilave me te rendesishmet jane mos-thirrja per t'u paraqitur e deshmitareve kryesore te propozuar ne menyre ligjore nga mbrojtja lidhur ceshtjen e pergjegjshmerise, dhe perdorimi jo i rregullt i procesverbaleve hetimore, qe perben shkelje te nenit 333 te Ligjit te Procedures Penale, shkelja e parimit te se drejtes se mbrojtjes per te qene e pranishme ne te gjitha seancat hetimore mos-marrja e nje aktgjykimi te kuptueshem, i cili vlereson sejcilen prove vecmas dhe ne lidhje me njera tjetren.

Gjate rigjykimit, gjykata e shkalles se pare duhet te vleresoje korrektesine dhe besueshmerine e deshmitareve, ceshtje e pergjegjshmerise pesonale te te akuzuarit ne pjesemarrjen ne krimet e pretenduara duke degjuar deshmitare te tjere te propozuar ne ankesat e mbrojtjesve, ne menyre qe te arrijne me se fundi te percaktojne nje gjendje faktike te qarte dhe jo-kontadiktore dhe te mund te aplikojne ligjin penal ne menyre te rregullt duke marre nje vendim te bazuar ne ligj dhe me nje arsystim te qarte dhe te plote.

Konventa Europiane e te Drejtave te Njeriut zbatohet sipas Rregullores se UNMIK-ut 1999/24 dhe 2000/59. Ne lidhje me kete, kohezgjatja e paraburgimit duhet te vleresohet ex-officio.

Sic eshte vendosur ne dispozitivin e ketij aktvendimi, paraburgimi mund te caktohet tani vetem mbi bazen e nenit 191, al.2, pika 1. Neni 191, al.2, pika 2, nuk eshte me i palikueshem per shkak te kohes qe ka kaluar qe kur kane ndodhur ngjarjet, meqe prishja e gjurmeve te vepres nuk eshte me mundshme, dhe as ndikimi mbi deshmitaret nuk do te kishte me kuptim ne nje faze te procedures kur te gjitha faktet jane te njohura gjeresisht. Prandaj, gjykata kompetente do te duhet te vleresoje detajisht provat ekzistuese, periudhen tashme te gjate te kaluar ne paraburgim dhe mundesi te tjera per te siguruar gjykimin dhe se fundi ekzekutimin e denimit.

Duke u bazuar ne cfare u tha me siper dhe ne baze te nenit 387, al. 1 e LPP u vendos si ne dispozitivin e ketij akt vendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVES NE PRISHTINE
AP. nr.145/2001 te dates 30.11.2001

Procesmbajtese

Muhamet Dabiqaj

Kryetare kolegjit

Renate Winter

